

## Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

### Thirrje për përgatitjen e një Videoje

Forumi Shqiptar Social Ekonomik-ASET është një OJF e themeluar në vitin 1999. Organizata po zbaton projektin Promovimi dhe ruajtja e vlerave kulturore, historike dhe artistike në Bashkinë Patos, i cili synon të promovojë turizmin kulturor dhe produktet artizanale nëpërmjet promovimit të potencialit turistik të zonës si dhe marketingut të produkteve tradicionale në Bashkinë Patos. Do të synohet promovimi i diversitetit të formave të turizmit kulturor dhe produkteve artizanale, forma të cilat po marrin zhvillim të madh vitet e fundit, duke promovuar turizmin e vizitorëve në zona jo shumë të promovuara në vendin tonë. Kjo lidhet edhe me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në zonë (duke konsumuar produkte vendase) dhe rritjen e prodhimit dhe shitjes së produkteve artizanale në zonë dhe veçanërisht në zonat rurale që janë edhe zona me akses më të ulët në treg dhe më zhvillim të pakët. **Në këtë kuadër të projektit do të përgatitet një video guide për prezantimin e pikave turistike dhe zonave atraktive në territorin e Bashkisë Patos. Me këtë qëllim ASET shpall thirrjen për subjektet të interesuara për realizimin e videos.** Ky projekt mbështetet nga ReLOaD2, i cili financohet nga BE dhe zbatohet nga UNDP.

#### Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 1 Nentor 2022, në adresën e e-mailit: [info@aset-al.com](mailto:info@aset-al.com) ose në adresën postare: Forumi Shqiptar Social Ekonomik, Rr. Dibrës, P 487 Sh 2, Tiranë. Subjekti që ofron shërbimin në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës dhe me çmimin më të ulët, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

#### I. KUSHTET PËR SUBJEKTE OFERTUESE

##### **Kushtet e Përgjithshme për Subjekt/biznes**

1. Subjekti duhet të jetë biznes i regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie dhe përgatitjen e videove.
2. Të ketë eksperiencë pune në fushë jo më pak se 1 vit.

##### **Kushtet e Përgjithshme për Individ**

1. Subjekti mund të jetë individ (person fizik).
2. Të ketë eksperiencë pune në fushë jo më pak se 1 vit.

##### **Përparësi kanë**



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



*Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

## Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

Subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Patos ose zona përreth.

### Dokumentacioni i kërkuar për aplikim:

#### A. Bizneset e interesuara duhet të paraqesin dokumentacioni si në vijim:

1. Dokument që provon se është i regjistruar si biznes për përgatitjen e videove (ekstrakt të QKB)
2. CV me links të punimeve të mëparshme
3. Të paraqesë ofertë financiare

#### B. Individët e interesuar duhet të paraqesin dokumentacioni si në vijim:

4. Letër interesi dhe referenca pune
5. CV me links të punimeve të mëparshme
6. Të paraqesë ofertë financiare.

**DOKUMENTACIONI DUHET DËRGUAR ELEKTRONIKISHT NË ADRESEN [INFO@ASET-AL.COM](mailto:INFO@ASET-AL.COM), BRENDË DATËS 1 NENTOR 2022, ORA 16.30 OSE NË ADRESËN POSTARE: FORUMI SHQIPTAR SOCIAL EKONOMIK, RR. DIBRËS, P 487 SH 2, TIRANË**

**NUK PRANOHEN OFERTAT DORAZI.**

### Specifikimet teknike të Videos

Kjo Video Guide duhet të prezantoj të gjitha objektet, zonat turistike dhe atraktive në territorin e Bashkisë Patos. Ato duhet të jenë të prezantuara më së miri dhe pamjet duhet të jenë shumë cilësore. Video duhet të përmbajë dhe filmime me Dron ku cilësia e filmimit duhet të jetë Full HD.

### Formati

- Rezolucioni duhet të jetë saktësisht në 1080p (1920 x 1080)
- Video duhet të kodohet si MP4 duke përdorur kodekun H.264.
- Gjerësia minimale është 1200 pixels (gjatësia varet nga raporti i pamjes) për Peizazh dhe Portret.
- Video duhet të jetë në raport 16:9.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



*Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

## Foumi Shqiptar Social Ekonomik - ASET

- Korniza maksimale të videos 30 fps.

### Madhësia e skedarit

- Kjo video guide duhet të jetë nga 100MB – 300 MB duke ruajtur cilësinë e pamjeve ose fonisë së videos.

### Shkrimi dhe gjuha e përdorur në Video

Të gjitha zonat dhe objektet që do të prezantohen në video duhet të shoqërohen me shpjegimin dhe emërtimin e tyre në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

### Kohëzgjatja e videos

Video duhet të jetë nga 4 minuta e 30 sekonda deri në 6 minuta e 30 sekonda. Në këtë kohëzgjatje video duhet të përfshijë më së miri të gjitha pikat turistike dhe zonat atraktive në territorin e Bashkisë Patos.

### Dorëzimi

Dorëzimi i Video Guide duhet të kryhet në USB dhe DVD.

### Videoja duhet realizuar dhe dorezuar brenda dates 20 Nentor 2022.

Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Për cdo informacion shtesë na shkruani në [info@aset-al.com](mailto:info@aset-al.com) ose në adresën postare: Forumi Shqiptar Social Ekonomik, Rr. Dibrës, P 487 Sh 2, Tiranë jo më vonë se data 29 Tetor 2022.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



*Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*